

Shoqëria “Refraktare” sha

Komuna Paper, Elbasan
NIPT:J62903317E

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME E AKSIONEREVE TË SHOQERISE “REFRAKTARE” SH.A.

NR 1 DATË 29.09.2021

Sot, më 29.09.2021, në orën 11, në selinë e shoqërisë Refraktare sh.a. u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë sipas Rendit të Ditës të njoftuar brenda afateve të parashikuara në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe në Statutin e saj.

Në mbledhje morën pjesë 27 aksionerë që përfaqësonin 86.01 % të kapitalit, e vërtetuar nga lista e pjesëmarrjes, që është nënshkruar rregullisht nga të gjithë të pranishmit dhe nga noteri. Mbledhja merr vendime me $\frac{3}{4}$ e aksionerëve me të drejtë vote. Kuorumi i kërkuar nga Ligji është përmbushur.

Asambleja shqyrtoi sa me poshte :

- Miratimin e raportit të Audituesit Ligjor për zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë;
- Miratimin e zvogëlimit të kapitalit të regjistruar.

Pas shqyrtimit të raportit të përgatitur nga Audituesi Ligjor për zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të shoqërisë, me burim kontributet në para të aksionarëve, me anë të zvogëlimit të vlerës nominale të aksionit, duke mbajtur të pandryshuar numrin e aksioneve për secilin aksionar, Asambleja e Përgjithshme

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin e Audituesit Ligjor, Shoqërisë audituese “VENIS-Audit & Finance” s.hp.k., për zvogëlimin e kapitalit të regjistruar me vlerë 8,297,444 Leke dhe te rezerves ligjore me vlerë 2,003,007 Leke, te shoqërisë Refraktare sh.a., me vlerë totale 10.300.451 (Dhjetë milion treqindmije e katerqind e pesedhete e nje) Lekë, me burim kontributet në para të aksionerëve dhe nga fitimi i caktuar për rritjen e reserves ligjore, me anë të zvogëlimit të vlerës nominale të aksionit, duke mbajtur të pandryshuar numrin e aksioneve për secilin aksioner. Nga vlera e rezerves ligjore si me lart, te mbahet dhe paguhet tatim ne burim me vlerë 300,451 Leke.
2. Të miratojë zvogëlimin e kapitalit të regjistruar ekzistues, për shumën 8,297,444 Leke (Tetëmilion e dyqind e nentdhete e shtate mije e katerqind e dyzet e kater) Lekë dhe të miratojë vlerën e mbetur të kapitalit të përbërë nga 503.187 aksione, me vlerë nominale 341.768 (treqind e dyzet e nje e 768/100) Lekë për aksioner, me vlerë totale 171.973.141

-1-



(Njëqind e shtatëdhjetëe një milion e nentëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e dyzet e nje) Lekë, i zotëruar nga aksionarët, sipas listës emrore bashkëlidhur, ANEKSI 1, e cila konsiderohet pjesë e këtij vendimi.

3. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë z. Gezim Hate, të regjistrojë këtë Vendim pranë Qendrës së Regjistrimit të Aksioneve sh.a. dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Administratës Tatimore.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE

Kryetari i Asamblesë:

Z. Agron Shaplo



Sekretarja e Asamblesë:

Znj. Angjelina Gjeta



Z. Gezim Hate

